



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L -228**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-050 PËR  
DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E PASURISË TË  
ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK DHE DEKLARIMIN,  
PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E DHURATAVE PËR TË  
GJITHË PERSONAT ZYRTARË**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-050  
PËR DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E  
PASURISË TË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK DHE DEKLARIMIN,  
PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E DHURATAVE PËR TË  
GJITHË PERSONAT ZYRTARË**

**Neni 1**

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1, nën-nënpagrafi 1.1.1 pas fjalës “**së Kosovës,**” shtohen fjalët “**dhe të emëruarit nga ai**”.

2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1 nën-nënpagrafi 1.1.4 pas fjalës “**Kryeshefat e Agjencive**” shtohen fjalët “**apo pozitat e barasvlershme**” si dhe pas fjalës “**tjetër,**” shtohen fjalët “**dhe zëvendësit e tyre**”.

3. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1 nën-nënparagrafi 1.1.6, pas fjalës “**Publike**” shtohen fjalët “**Kryeshefat, Zëvendës Kryeshefat, sekretarët e ndërmarrjeve publike të nivelit qendror dhe lokal,**”.

4. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1 nën-nënparagrafi 1.1.11. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.1.11. Udhëheqësit e të gjitha Departamenteve, Drejtorive, Drejtorateve apo njërive të barasvlershme, Udhëheqësit e Financave dhe Prokurimit publik në të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet publike;

5. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1 nën-nënparagrafi 1.1.13 pas fjalëve “**prorektorët e Universitetit Publik,**” shtohen fjalët “**anëtarët e Këshillit Drejtues të Universitetit Publik,**”.

6. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1 nën-nënparagrafi 1.1.18 pas fjalës “**kryeinspektorët**” shtohen fjalët “**dhe zëvendës kryeinspektorët**”.

7. Në nenin 3 të ligjit bazik, pas nën-nënparagrafit 1.1.18 shtohet nën-nënparagrafi i ri 1.1.19 me tekstin si në vijim:

1.1.19. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

8. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1 nën-nënparagrafi 1.2 riformulohet me tekstin si në vijim:

1.2. Anëtar i familjes – bashkëshortët, bashkëshortët jashtëmartesorë, prindërit dhe fëmijët me të cilët jeton në bashkësi familjare.

9. Neni 3 i ligjit bazik, nënparagrafët 1.4, 1.5 dhe 1.6 fshihen dhe shtohet nën paragrafi i ri 1.4. me tekstin si në vijim:

1.4. Të gjithë ushtruesit e detyrës në pozitat e lartpërmendura nga neni 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 nën-nënparagrafët 1.1.1 deri 1.1.19 që ushtrojnë detyrën më gjatë se tre (3) muaj, janë të obliguar të deklarojnë pasurinë.

## Neni 2

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 2 fjala “**institucion**” zëvendësohet me fjalën “**zyrtar kontaktues**”.

2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, pas fjalës “**Agjencia**” shtohen fjalët “**nga data 1 mars**”.

### **Neni 3**

1. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 fjala “**pesëmijë (5000)**” zëvendësohet me fjalën “**tremijë (3000)**”.

2. Neni 5 i ligjit bazik, nënparagrafët 1.5, 1.6 dhe 17 riformulohen me tekstin si në vijim:

1.5. para të gatshme, në llogari rrjedhëse, në depozita dhe në huadhënie në euro ose në valuta tjera të huaja

1.6. të drejtat dhe detyrimet financiare ndaj personave fizik dhe juridik

1.7. të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale.

### **Neni 4**

Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1, pas fjalës “**kalendarik**” shtohen fjalët “**për vitin paraprak nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor**”.

### **Neni 5**

Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2 fshihet.

### **Neni 6**

1. Neni 11 i ligjit bazik, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 2a. me tekstin si në vijim:

2a. Dhurata të rastit konsiderohen dhuratat e vogla me vlerë deri në njëzetepesë (25) Euro. Zyrtari nuk mund të pranoj dhurata të rastit vlera e përgjithshme e të cilave kalon mbi pesëqind (500) Euro brenda vitit.

2. Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 3 pas fjalës “**dhuratë**” shtohet fjala “**të rastit**”.

3. Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 4 pas fjalës “**monetare**” shtohen fjalët “**letra me vlerë dhe metale të çmuara pa marrë parasysh vlerën e tyre**”.

4. Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 5 pas fjalës “**dhuratën**” shtohen fjalët “**për regjistrim te zyrtari kontaktues i institucionit përkatës**”.

#### **Neni 7**

1. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 1 pas fjalës “**personave**” shtohen fjalët “**apo institucioneve**”.

2. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 2, fjala “**zyrtarët përgjegjës**” zëvendësohet me fjalën **zyrtarët kontaktues**.

3. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 4, fshihen fjalët “**Regjistri i dhuratave është publik**”.

4. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 5 riformulohet me tekstin si në vijim:

5. Institucionet publike mbajnë regjistra të posaçëm për dhurata. Agjencia, brenda gjashtëdhjetë(60) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, harton formatin e mbajtjes së regjistrave dhe ua përcjell institucioneve publike.

5. Neni 12 i ligjit bazik, pas paragrafit 8 shtohet paragrafi i ri 9 me tekstin si në vijim:

9. Institucionet dhe Agjencia kanë detyrim ligjor për mbajtjen e regjistrave të dhuratave për dhjetë (10) vjet.

#### **Neni 8**

Neni 14 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

#### **Neni 14 Autoriteti Kompetent**

Agjencia është institucion qendror për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

#### **Neni 9**

1. Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 3, fjala “**përpunimi**” zëvendësohet me fjalën “**kontrolli**”.

2. Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 4, pas fjalës “**formular**” shtohen fjalët “**dhe krahasimin e të dhënave me formularët paraprak**”.

3. Neni 15 i ligjit bazik, pas paragrafit 4, shtohen paragrafët e rinjë 5, 6, 7 dhe 8 me tekstin si në vijim:

5. Kur gjatë kontrollit të plotë zbulohet se deklarimi nuk është i saktë ose burimi i deklaruar nuk identifikohet dhe nuk mbulon pasuritë e deklaruara, Agjencia kërkon nga zyrtari për të dhënë shpjegime dhe argumente përkatëse të cilat paraqiten me shkrim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

6. Kontrollit të plotë çdo vit i nënshtrohen të paktën njëzet përqind (20%) e formularëve. Përzgjedhja e deklaratave që i nënshtrohen kontrollit të plotë bëhet me short. Procedura e shortit është e hapur për publikun. Lista e zyrtarëve ndaj të cilëve ushtrohet kontrolli i plotë është publike. Agjencia publikon tridhjetë (30) ditë përpara datës së hedhjes së shortit dhe pesëmbëdhjetë (15) ditë pas hedhjes së shortit listën e zyrtarëve që i nënshtrohen kontrollit të plotë. Publikimi bëhet nëueb faqen zyrtare të Agjencisë dhe në të paktën në një gazetëditore.

7. Agjencia ushtron kontroll të plotë ndaj zyrtarit edhe me kërkesë të publikut apo personave të interesuar.

8. Agjencia nxjerr rregullore për ushtrimin e kontrollit të plotë gjashtëdhjetë (60) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## **Neni 10**

Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 3, pas fjalës “**detyrimin për deklaram**” shtohen fjalët “**në pajtim me Kodin e Procedurës Penale**”.

## **Neni 11**

Neni 17 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

## **Neni 17**

1. Agjencia paraqet kallëzim penal në prokurorinë kompetente ndaj zyrtarit të lartë publik i cili shkel detyrimet e parapara me këtë ligj, e që përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

2. Për iniciimin e procedurës penale, Agjencia e njofton udhëheqësin e institucionit në të cilin zyrtari i lartë publik punon ose ka punuar.

3. Agjencia publikon emrat e zyrtarëve të lartë publik të cilët nuk e kanë deklaruar gjendjen e pasurisë ashtu siç është paraparë me ligj.

#### **Neni 12**

Neni 18 i ligjit bazik fshihet.

#### **Neni 13**

Neni 19 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

#### **Neni 19 Dispozitat Kalimtare**

Të gjitha procedurat për vepra kundërvajtëse të cilat janë iniciuar sipas ligjit deri me 31.12.2012 zgjidhen sipas dispozitave të ligjit që ka qenë në fuqi.

#### **Neni 14 Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L -228**  
**20 mars 2014**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**